

NJOFTIM

Njoftohen të gjitha subjektet të cilat kërkojnë të kryejnë dëgjese me publikun, në zbatim të VKM-së Nr. 419, datë 25.06.2014 *“Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”*, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 247, datë 30.04.2014 *“Përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”*, i ndryshuar, zhvilluesi ka për detyrë që përpara aplikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) përveç dërgimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të dërgojë edhe në Njësinë e Qeverisjes Vendore (NJQV), ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim ose në formë elektronike, për aplikimin që do të kryejë për t’u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, VNM Paraprake (Hec) dhe VNM të Thelluar, përkatësisht *“Formularin tip I”* për aplikim për leje mjedisi A dhe B, *“Formularin tip I”* për VNM të Thelluar si dhe *“Përmbledhjen joteknike”*.